
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-850/022	Data: Datum: 04.11.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 8 të Rregullores MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 02.Nr.69/2022 të datës 03.11.2022 të parashtuar nga Drejtoria për Administratë Komunale, për themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për vlerësimin e projekteve të OJQ-vë, për projektin: “16 ditë të aktivizimit kundër dhunës në familje”, të cilët kanë aplikuar në thirrje publike të publikuar me 25.10.2022, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për vlerësimin e projekteve të OJQ-vë, për projektin: “16 ditë të aktivizimit kundër dhunës në familje”, të cilët kanë aplikuar në thirrje publike të publikuar me 25.10.2022 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Servete Haxhijaj**, përfaqësuese e Drejtorisë për Administratë Komunale, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Hatixhe Bujupaj**, përfaqësues i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, anëtare;
- 1.3. Fisnik Shoshi**, përfaqësues nga Drejtoria për Shëndetësi, anëtar;
- 1.4. Faruk Shala**, përfaqësues nga organizata joqeveritare (OJQ);
- 1.5. Aulona Zogaj**, eksperte e jashtme, anëtare.

2. Anëtar rezervë caktohet:

- 1.1. Arlinda Kurtaj**, Udhëheqëse e Sektorit për të Drejta të Njeriut.

3. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha projekteve konkurruese në bazë të thirrjes publike për mbështetje financiare të OJQ-ve të datës 25.10.2022, të përpiloj listën e OJQ-ve dhe ti rendit sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit të projekteve, me listën e përpiluar të njofton Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin për Administratë Komunale si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni për vlerësimin e projekteve dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

5. Vendimi është përfundimtar

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI